

Nr. 1902 / datë 21.3. 2023

Nr. 033 datë 22.03 2023

URDHËR/ VENDIM I PËRBASHKËT

PËR

NGRITJEN E GRUPIT TË PËRBASHKËT TË PUNËS PËR ORGANIZIMIN DHE REALIZIMIN E SEMINARIT XVI "PËR ORGANIZIMIN E PËRBASHKËT TË MËSIMIT TË GJUHËS SHQIPE DHE KULTURËS SHQIPTARE NË DIASPORË"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 11 dhe pikës 2, të nenit 26 të ligjit nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 5 të ligjit nr. 04/L-032 "Për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës" dhe Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, të Republikës së Kosovës, "Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë", datë 23 mars 2015,

URDHËROJMË/VENDOSIM:

1. Të ngrihet grupi i përbashkët i punës për organizimin dhe realizimin e Seminarit XVI "Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë", me përbërje si vijon:
 - a) Anila Ferizaj, kryetar, MAS, Shqipëri;
 - b) Shqiponja Lamçe, anëtar, MAS, Shqipëri;
 - c) Besnik Rama, anëtar, MAS, Shqipëri;
 - d) Erida Koleci, anëtar, ASCAP, Shqipëri;
 - e) Ilda Lokaj, anëtar, ASCAP, Shqipëri;
 - f) Jona Sulaaj, anëtar, ASCAP, Shqipëri;
 - g) Mimoza Çuliqi, anëtar, QBD, Shqipëri.
 - a) Shqipe Gashi, kryetar, MASHTI, Kosovë;
 - b) Besjane Krasniqi, anëtar, MASHTI, Kosovë;
 - c) Arian Mustafa, anëtar, MASHTI, Kosovë;
 - d) Feime Llapashtica, anëtar, MASHTI, Kosovë;
 - e) Sylë Ukshini, anëtar, MPJD, Kosovë;
 - f) Barbana Dobra, anëtar, MPJD, Kosovë;
 - g) Burbuqe Matoshi, anëtar, MPJD, Kosovë.

2. Grupi i përbashkët i punës, ka për detyrë:
 - a) Të njoftojë në faqen e web-it të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), të Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) të Republikës së Kosovës mënyrën e aplikimit për pjesëmarrje dhe referime në seminar.
 - b) Të bëjë përzgjedhjen e materialeve të seminarit .
 - c) Të hartojë programin e veprimtarive që do të zhvillohen gjatë ditëve të seminarit.
 - d) Të miratojë listën e pjesëmarrësve në seminar.
 - e) Të hartojë preventivin për parashikimin dhe financimin e shpenzimeve të nevojshme për organizimin e seminarit.
 - f) Të hartojë raportin përfundimtar të seminarit.
3. Shpenzimet e realizimit të seminarit të mbulohen në masën 50 (pesëdhjetë) përqind nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) dhe 50 (pesëdhjetë) përqind nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, sipas parashikimit/preventivit.
4. ASCAP-i mbulon shpenzimet e udhëtimit me autobus nga Tirana në destinacion, vajtje – ardhje për pjesëmarrësit që do të nisen nga Shqipëria, si dhe vlerën e biletave në rrugë tokësore të mësuesve që vijnë nga Greqia. Pagesat për këta të fundit do të kryhen nëse çdo pjesëmarrës do të paraqesë pranë Zyrës së Financës së ASCAP-it biletat origjinale të udhëtimit që përkojnë me datat e zhvillimit të seminarit.
5. Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD) kryen funksionet e sekretariatit teknik gjatë procesit të organizimit dhe realizimit të seminarit.
6. Për zbatimin e këtij urdhri/vendimi të përbashkët ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës, Qendra e Botimeve për Diasporën, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, dhe grupi i përbashkët i punës.

Ky urdhër/ vendim i përbashkët hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT I
REPUBLICËS SË SHQIPËRISË**

EVIS KUSHI



**MINISTËR I ARSIMIT, SHKENCËS
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT I
REPUBLICËS SË KOSOVËS**

ARBËRIE NAGAVCI

